

VENDIM
Nr. 107, datë 29.6.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY” SHPK ME NR. 3, SERIA.PV03K,
DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 69,
DATË 12.12.2007

Në mbështetje të neneve 16, 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 930, datë 2.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei” s.p.a., miratuar me vendimin nr. 148, datë 22.3.2007, të Këshillit të Ministrave, nenit 15 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, miratuar me vendimin nr. dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, për modifikimin e licencës së shoqërisë “Balkan Green Energy”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Favina” sh.p.k. në cilësinë e pronarit të HEC “Voskopojë” i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 100 prot., datë 21.1.2016, duke kërkuar rritjen e fuqisë së instaluar të këtij HEC-i.

- ERE pas verifikimeve të bëra, konstaton se mbështetur në vendimin nr. 69, datë 12.12.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është shoqëria koncesionare “Balkan Green Energy” sh.p.k., e licencuar për të ushtruar aktivitetin e prodhimit nga HEC “Voskopoja”.

- ERE, me shkresën nr. 101/1 prot., datë 20.4.2016, i është drejtuar MEI-t, në lidhje me saktësimin e pronësisë së HEC “Voskopojë”.

- MEI është përgjigjur me shkresën nr. 2810/1, datë 23.5.2016, përmes së cilës i ka kërkuar ERE-s, zbatimin e marrëveshjes së koncesionit në për-puthje me VKM-në nr. 930, datë 2.9.2009.

- VKM-në nr. 930, datë 2.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei” s.p.a., miratuar me vendimin nr. 148, datë 22.3.2007, të Këshillit të Ministrave ka hequr nga lista e HEC-eve për të cilat është licencuar shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. HEC-et: “Piqeras”, “Lozhan” dhe “Voskopojë”, në zbatim të nenit 5, i cili përcakton se: “Trajtimi i hidrocentraleve Piqeras, Lozhan dhe Voskopojë, do të merren në dorëzim dhe do të trajtohen nga Organi Shtetëror i Autorizuar”.

- Neni 43, pika 1, e ligjit nr. 43/2015, parashikon se: ERE mund të modifikojë licencën, me iniciativën e vet, kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me numër nr. 3, seria PV03K, dhënë shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k., me vendim të Bordit të ERE-s nr. 69, datë 12.12.2007, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 930, datë 2.9.2009.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti